

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

Standardet e të arriturave arsimore për përfundimin e arsimit të mesëm

Kompetenca e përgjithshme lëndore (KPL)

Nxënësit kanë njohuri për funksionin dhe rëndësinë e gjuhës dhe shumëgjuhësisë, dinë gramatikën e gjuhës shqipe dhe e zbatojnë atë në jetën e përditshme. E kuptojnë ndikimin e gjuhës dhe e shfrytëzojnë në mënyrë të përgjegjshme shoqërore, duke zhvilluar përgjegjësinë e tyre qytetare dhe përfshirjen sociale. Kujdesen dhe e ruajnë gjuhën shqipe duke respektuar llojllojshmërinë e dialekteve të saj, sikur edhe gjuhët tjera.

Shfrytëzojnë fjalor të zhvilluar e të pasur në komunikimin me shkrim dhe me gojë: folin dhe shkruajnë duke respektuar normën letrare dhe drejtshkrimore, mishërojnë tekst të përshtatshëm logjik e stilor. Kujdesen për kulturën e dialogut, zotërojnë shkathtësi të të folurit dhe shkathtësitë e të dëgjuarit aktiv. Formulojnë dhe shprehin argumente shkrimore në mënyrë bindëse që i përgjigjet kontekstit. Komunikojnë në mënyrë konstruktive, bashkpunojnë në ekipe dhe bisedojnë, duke zhvilluar ndieshmërinë për nisma dhe veprim në arritjen e qasës duke shfrytëzuar mjetet e teknologjisë komunikuese – informative.

Kanë të zhvilluar aftësinë e e leximit. Kuptojnë, kritikisht e në mënyrë kreative e shohin tekstin letrar dhe joartistik (joletrar). Kujdesen për kulturën e të folurit dhe të lexuarit për tu ngritur e për ta përmbushur më shumë veten. Kërkojnë, mbledhin dhe kritikisht i përpunojnë informacionet e burimeve të llojeve të ndryshme dhe përgjegjshëm i shfrytëzojnë dhe krijojnë përmbajtje multimediale.

Interpretojnë pjesë letrare nga letërsia nacionale e botërore. Kuptojnë dimensionin multikultural të letërsisë dhe mënyrën se si letërsia kombëtare i kontribuon trashëgimisë kulturore botërore. Vërejnë dhe me shembuj argumentojnë veçoritë themelore poetike, gjuhësore, estetike e strukturore të pjesëve letrare. Posedojnë aftësinë e shprehshmërisë së ideve, përvojave dhe emocioneve në mënyrë figurative e abstrakte; manifestojnë aftësi krijuese. Shfrytëzojnë leximin që të njohin më mirë veten, të tjerët dhe botën rreth tyre duke adoptuar e ndërtuar parimet etike. Duke lexuar zhvillojnë empatinë dhe kujdesin për njerëzit dhe botën. Kujdesen për raporte humane e kritike në forma të ndryshme kulturore. Vendosin lidhje mes letërsisë dhe arteve tjera, shkencave dhe teknologjisë.

Në mënyrë efikase shfrytëzojnë teknika të llojllojshme të mësimnxënies dhe janë të vetdijshëm për mësimin e përhershëm. Etikisht dhe përgjegjshëm i qasen pronësisë intelektuale e kulturore.

Niveli fillestar

Kompetenca specifike lëndore 1 (KSL1)

Nxënësit dinë format themelore të gjuhës letrare shqipe. Njohin normën letrare e drejtshkrimore, gramatikën dhe stilistikën e gjuhës shqipe. Janë të orientuar nga pasurimi i fjalorit të tyre, shprehësisë gjuhësore e stilore. Flasin qartë dhe pastër, dallojnë shprehësinë formale dhe joformale, komunikimin verbal dhe joverbal. Njohin rregullat e shkrimit të teksteve të llojeve të ndryshme. Lexojnë dhe kuptojnë tekste lineare dhe jolineare; dallojnë tekstin letrar nga teksti joletrar. Lidhin veprat letrare me autorët e tyre dhe periudhat letrare. Vendosin elementet themelore strukturore të tekstit letrar dhe joletrar.

Kompetenca specifike lëndore 2 (KSL2)

Nxënësit kanë shkathtësi të të dëgjuarit dhe të folurit dhe i zbatojnë në përputhje me ngjarjen komunikuese. Zbatojnë njohuri teorike nga gramatika në situatën konkrete gjuhësore dhe shkruajnë duke zbatuar rregullat drejtshkrimore. Ndërtojnë tekst të shkruar e të folur logjik, mirë të strukturuar dhe të përshtatshëm stilor. Shprehen me gojë e me shkrim në mënyrë bindëse që i përshtatet kontekstit duke respektuar barabartësinë racore, kombëtare, kulturore, gjuhësore, fetare, gjinore, të afërsisë e rritshmërisë. Vërejnë qëllimet e autorit në tekst (informimin, manipulimin). Gjatë leximit dhe interpretimit të tekstit letrar dhe joletrar zbatojnë metoda të ndryshme. Leximin e marrin si hobi dhe zgjedhjnë interesimet e tyre nga letërsia për të rinj kah trillimi i përgjithshëm. Shfrytëzojnë fondet e bibliotekave dhe arkivave, vizitojnë ekspozitat, shikojnë shfaqjet teatrale dhe filmat.

Kompetenca specifike lëndore 3 (KSL3)

Nxënësit kujdesen dhe ruajnë gjuhën shqipe duke respektuar barabartësinë e dialekteve të saj (vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit, Tiranë, 1972); respektojnë gjuhët e të tjerëve dhe gjuhët e huaja. Janë të aftësuar që të shprehen me shkrim e me gojë në mënyrë të drejtë, qartë, ekonomikisht dhe bindshëm. Duke lexuar dhe interpretuar veprat letrare nga letërsia vendase dhe botërore, formojnë qëndrime dhe bindshmëri humanistike e pasurore. Vendosin lidhje mes artit letrar, teatral e filmik. Shfrytëzojnë aftësinë e të lexuarit dhe strategji të ndryshme të të lexuarit e të mësuarit. Paranjohin paragjykimet, stereotipet dhe format e agresionit verbal (sjellje jo e sjellshme, mosrespektim i bashkëbiseduesit, fyerje, gjuhë e urrejtjes dhe të ngjash.) si dukuri negative. Shfrytëzojnë njohuritë nga gjuha dhe letërsia në situatat e rëndësishme për kyçje aktive qytetare. Etikisht dhe përgjegjshëm i qasen pronësisë intelektuale dhe kulturore.

Rezultatet e ciklit arsimor (RCA) për fund të arsimit të mesëm:

Niveli fillestar		
KSL 1	KSL 2	KSL 3
<i>Nxënësit :</i>	<i>Nxënësit :</i>	<i>Nxënësit :</i>
– SHQI.AM.F.1.1. Dinë format themelore të gjuhës letrare shqipe (shkrimi, shqiptimi, dialektet). – SHQI.AM.F.1.2. Dallojnë shqiptimin e drejtë nga joidrejtë dhe klasifikojnë tingujt sipas kriterëve të dhëna. – SHQI.AM.F.1.3. Kuptojnë konceptin e rrokjes, njohin rregullat themelore të normës akcentuale dhe vërejnë akcentet joletrare në komunikimin e përditshëm. SHQI.AM.F.1.4. Klasifikojnë llojet e fjalëve; dallojnë kategoritë gramatikore të llojeve të ndryshueshme të fjalës në shembuj tipik shkollor. SHQI.AM.F.1.5. Dallojnë fjalët e thjeshta dhe fjalët e përbëra, sipas modelit të dhënë. SHQI.AM.F.1.6. Klasifikojnë llojet themelore të fjalëve; dallojnë	SHQI.AM.F.2.1. Zbatojnë njohuritë teorike nga gramatika në situatën (tekstin) konkrete gjuhësore. SHQI.AM.F.2.2. Shkruajnë duke zbatuar rregullat drejtshkimore, përfshi vendimet tipografike – drejtshkimore në tekstin e shtypur duke shfrytëzuar drejtshkrimin përgjegjës. SHQI.AM.F.2.3. Lexojnë tekste letrare dhe joletrare (lineare dhe jolineare); me kujdes dhe me kuptueshmëri dëgjojnë deklaratimet e thjeshta dhe mbajnë shënime, përcaktojnë fjalët kyçe. SHQI.AM.F.2.4. Shprehin përjetimin subjektiv e estetik për tekstin e folur ose të shkruar; lidhin përmbajtjen e veprës letrare me përvojën e tyre ose të huaj. SHQI.AM.F.2.5. Vërejnë motivet kryesore, tematikën dhe tiparet e dallueshme stilistike të veprave letrare të drejtimit të caktuar letrar, dallimet tipike dhe ngjashmëritë në raport me epokat e kaluara letrare.	SHQI.AM.F.3.1. Shfrytëzojnë njohuritë nga gjuha në mënyrë që të shprehen drejt me shkrim dhe me gojë në kontekstin arsimor, në jetën private dhe publike, në situatat e rëndësisë për kyçe aktive qytetare. SHQI.AM.F.3.2. Paraqesin informacione në forma të ndryshme (me gojë, me shkrim, në mënyrë vizuale, dixhitale). SHQI.AM.F.3.3. Shprehin mendimin e tyre në mënyrë argumentuese dhe zgjedhin shprehjen gjuhësore në pajtim me kontekstin, përfshi komunikimin konstruktiv në bashkpunim me të tjerët, në grupe, në rrjetet sociale. SHQI.AM.F.3.4. Njohin dhe i vërejnë paragjykimet dhe stereotipet në tekstet letrare dhe joletrare dhe në deklarin gojor, sikur edhe format e agresionit verbal (sjellje e papërshtatshme, mosrespektim i bashkëbiseduesit, fyerje, gjuhë e urrejtjes dhe të ngjash.) në situatat e përditshme dhe në media si shfaqje

fjalitë e pavarura nga të varurat. SHQI.AM.F.1.7. Kuptojnë domethënien e fjalës, shprehjeve të vendosura dhe frazeologjizmave me të cilat ndeshen në komunikimin e përditshëm, në lektyra dhe tekstet shkollore nga lëndët tjera. SHQI.AM.F.1.8. Dallojnë leksikun formal nga leksiku joformal dhe e shfrytëzojnë në pajtushmëri me situatën; njohin dukuritë leksikore dhe raportet leksikore dhe i zbatojnë në situatat komunikative. SHQI.AM.F.1.9. I dinë dhe i zbatojnë rregullat drejtshkrimore. SHQI.AM.F.1.10. Dinë rregullat e të shkruarit të llojeve të ndryshme të teksteve (psh. letra, imejli, biografia, lutja, ankesa, raporti..); sipas normës plotësojnë modele të ndryshme. SHQI.AM.F.1.11. Lidhin veprat letrare me autorët e tyre dhe periodhat kur janë shkruar. SHQI.SHM.F.1.12. Dallojnë	SHQI.AM.F.2.6. Përmbledhin, citojnë, pararrëfejnë/parafratojnë tekstin duke ndarë të rëndësishmen; interpretojnë tekstin; dallojnë informacionin nga interpretimi. SHQI.AM.F.2.7. Formësojnë të folurit e të shkruarit e tyre sipas situatës komunikative (zgjedhin mjete përgjegjëse të të shprehurit – verbale dhe joverbale, leksikun dhe format e të treguarit). SHQI.AM.F.2.8. Gjejnë informacione në tekst (në linear dhe jolinear) sipas kriterit të dhënë; gjejnë mënyra për tu njohur me informatën të cilën nuk e kuptojnë; zgjedhin dhe klasifikojnë burimet e informacionit; njohin teknikën e manipulimit në tekst dhe në të folur. SHQI.AM.F.2.9. Marrin pjesë në mësimin e projektuar dhe proceset kreative dramatike; shfrytëzojnë fondin e bibliotekës, shikojnë shfaqjet teatrale dhe filmat, vizitojnë ekspozitat ...	negative. SHQI.AM.F.3.5. Shfrytëzojnë aftësitë e të lexuarit si mjet për mësim dhe kuptueshmëri më të mirë të lëndëve tjera. SHQI.AM.F.3.6. Shfrytëzojnë strategji të ndryshme të të lexuarit dhe të mësuarit në pajtim me qëllimin e vendosur. SHQI.AM.F.3.7. Kanë të zhvilluar pasionin për lexim dhe kuptojnë rëndësinë e leximit për zhvillim të përgjithshëm të kulturës dhe njohurive të tyre. SHQI.AM.F.3.8. Njohin rëndësinë e letërsisë dhe kulturës në jetën e tyre; vlerësojnë letërsinë si pjesë e rëndësishme e kulturës kombëtare dhe si mjet për promovimin e kulturave të ndryshme. SHQI.AM.F.3.9. Shfrytëzojnë njohuri nga gjuha dhe letërsia për të marrë pjesë në manifestime të ndryshme kulturore. SHQI.AM.F.3.10. Shfrytëzojnë alfabetin e gjuhës shqipe, ndërtojnë tekst të shkruar dhe gojor; përgjegjshëm i qasen çështjeve që lidhen me pronësinë intelektuale; munden të citojnë dhe /ose
---	--	---

tekstin letrar nga joletrar; vendosin për elementet themelore të strukturës së veprave letrare artistike; tema, motive, ngjarja, personazhet, koha dhe vendi i ngjarjes. SHQI.AM.F.1.13. Dallojnë karakteristikat e letërsisë popullore nga karakteristikat e letërsisë së shkruar; njohin format themelore të llojeve e gjinive letrare; vërejnë elementet lirike, epike e dramatike në veprën letrare. SHQI.AM.F.1.14. Dallojnë pararrëfimin nga analiza e veprës. SHQI.AM.F.1.15. Lidhin motivet/temat nga letërsia dhe historia e artit me njohuritë themelore nga historia.		parafrazojnë tekste. SHQI.AM.F.3.11. Kuptojnë rëndësinë që ka gjuha në kujdesin për identitetin kulturor e kombëtar; kuptojnë të drejtën për shfrytëzim të gjuhës amtare dhe respektojnë gjuhët e të tjerëve në vend. SHQI.AM.F.3.12. Respektojnë të drejtat e njeriut të të tjerëve; kuptojnë babartësinë mes njerëzve. SHQI.AM.F.3.13. Kuptojnë rolin e mediave tradicionale dhe bashkëkohore në shoqërinë demokratike. SHQI.AM.F.3.14. Njohin lidhjen mes artit letrar, teatral e filmik në interpretimin e temave të njëjta.
--	--	---

Niveli i mesëm

Kompetenca specifike lëndore 1 (KSL 1)

Nxënësit njohin grupet themelore të gjuhëve në Europë dhe e dinë vendin e gjuhës shqipe në mesin e gjuhëve indoeuropiane. Kanë njohuri të gjëra për zërat e gjuhës shqipe, njohin rregullat duke theksuar fjalët dhe dallojnë akcentin letrar nga ai joletrar. Kanë njohuri të gjëra për llojet e nënlojet e fjalëve, format e tyre dhe mënyrave të ndërtimit të tyre. Analizojnë fjalitë e ndërtuara sipas modeleve të ndryshme. Kanë fjalor të zhvilluar në pajtim me arsimimin dhe munden ta shfrytëzojnë fjalën e kërkuar në pajtim me rastin e dhënë; janë të orientuar në pasurimin e mëtejshëm të fjalorit të tyre. Shfrytëzojnë strategji të të lexuarit në pajtim me qëllimet e leximit dhe llojet e tekstit. Njohin dhe interpretojnë veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe dhe botërore dhe i lokalizojnë në kontekstin historik letrar; kuptojnë konceptet themelore teorike letrare dhe historike letrare. Njohin forma të ndryshme të deklarimit mediatik.

Kompetenca specifike lëndore 2 (KSL 2)

Duke kërkuar për gjuhën dhe letërsinë shqipe, nxënësit e krahasojnë me gjuhët tjera dhe zhvillojnë kureshtjen dhe kompetencën për komunikim ndërkultural. Me rregull lexojnë vepra letrare. Shfrytëzojnë burime të ndryshme të informacionit, vlerësojnë besueshmërinë e burimit, përpunojnë informacionet, i zgjedhin sipas relevancës dhe në mënyrë të argumentuar i paraqesin në pajtim me situatën komunikative, duke përshtatur gjuhën dhe formën e shprehjes grupeve të ndryshme të caktuara.

Kompetenca specifike lëndore 3 (KSL 3)

Nxënësit vlerësojnë metodat e tyre komunikuese dhe aftësitë e interaksionit. Kanë fjalor të pasur dhe e shohin gjuhën si një nga mundësitë e shprehjes dhe krijimit të vlerave kulturore, shoqërore dhe materiale. Krijojnë dhe çmojnë përmbajtje të ndryshme kulturore. Kuptojnë dimensionin multikultural të letërsisë dhe mënyrën se si letërsia kombëtare i shërben kopshtit kulturor botëror. Zhvillojnë aftësi të të menduarit kritik dhe aftësi analitike.

Rezultatet e ciklit arsimor (RCA) për përfundimin e arsimit të mesëm:

Niveli i mesëm		
KSL 1	KSL 2	KSL 3
<i>Nxënësit:</i>	<i>Nxënësit:</i>	<i>Nxënësit:</i>
– SHQI.AM.M.1.1. Klasifikojnë gjuhët në grupet kryesore të gjuhëve në Europë, e njohin vendin e gjuhës shqipe në familjen e gjuhëve indoeuropiane dhe i dallojnë dialektet e gjuhës shqipe bazuar në veçoritë e tyre. – SHQI.AM.M.1.2. Njohin etapat kryesore në zhvillimin e gjuhës letrare shqipe si dhe monumentet më të rëndësishme kulturo-historike. – SHQI.AM.M.1.3. Njohin normën e gjuhës standarde në lidhje me theksin; dinë të përcaktojnë gjatësinë dhe cilësinë e rrokjes dhe zbatojnë rregullat e theksit në shembuj të thjeshtë (theksi te fjalët njërrrokëshe). Në fjali mund t'i dallojnë llojet e theksave (theksi i lirë, dinamik, ritmik, logjik dhe i fjalisë). – SHQI.AM.M.1.4. Vërejnë ndryshimin e fonemave në shembuj të ndryshëm dhe i lidhin ato sipas normës së gjuhës standarde. – SHQI.AM.M.1.5. Përcaktojnë klasën e fjalëve të ndryshueshme dhe veçoritë e tyre gramatikore; si dhe i përcaktojnë të gjitha format e foljeve. Shkruajnë fjali sipas rregullave gramatikore dhe i	– SHQI.AM.M.2.1. Zbatojnë njohuritë teorike nga gramatika, vërejnë, ilustrojnë dhe analizojnë dallimet gjuhësore në situata të ndërlikuara gjuhësore. – SHQI.AM.M.2.2. Vërejnë dhe i përmirësojnë gabimet drejtshkrimore në tekstet e tyre dhe te të tjerët në përputhje me normën drejtshkrimore; dallojnë theksin letrar dhe trajtat në komunikimin e përditshëm. – SHQI.AM.M.2.3. Zbatojnë teknika të ndryshme të të lexuarit dhe ia përshtatin natyrës së tekstit dhe qëllimit. – SHQI.AM.M.2.4. Rregullisht lexojnë vepra letrare nga programi dhe i zgjedhin veprat sipas zgjedhjes së tyre të lirë duke zhvilluar shprehitë e të lexuarit, kriteret estetike dhe gjykimet. – SHQI.AM.M.2.5. E përjetojnë veprën në çdo aspekt duke i shfaqur përjetimet e tyre, interpretojnë lloje të ndryshme të teksteve, i lidhin, i krahasojnë si dhe i arsyetojnë konkluzionet e tyre me faktet nga	– SHQI.AM.M.3.1. Formojnë dhe shprehin qartë mendimin e tyre duke përdorur e respektuar normën e gjuhës standarde shqipe me konventat shoqërore dhe dallimet kulturologjike. – SHQI.AM.M.3.2. Vërejnë lidhjen midis mënyrës së të shprehurit dhe qëndrimin e autorit; vlerësojnë përdorimin e informatave dhe burimet e besueshme. – SHQI.AM.M.3.3. Përdorin aftësitë e bashkëpunimit, kulturën e tyre të të shprehurit verbal dhe jo verbal, si dhe të dëgjuarit dhe respektimin e mendimit të tjetrit. – SHQI.AM.M.3.4. Respektojnë shumëllojshmërinë e identiteteve kulturore në Europë dhe botë. – SHQI.AM.M.3.5. Zhvillojnë shkrim-leximin në sfera të ndryshme (artistike, dixhitale, informatike, financiare, shëndetësore, mediatike, shkencore, matematikore...). – SHQI.AM.M.3.6. Përshtasin

klasifikojnë në njësi sintaksore. – SHQI.AM.M.1.6. Dallojnë të gjitha llojet e fjalëformimeve. – SHQI.AM.M.1.7. Analizojnë sintagmat dhe fjalitë e ndërtuara sipas modeleve themelore. – SHQI.AM.M.1.8. Njohin llojet dhe funksionet e fjalive të varura. – SHQI.AM.M.1.9. Njohin kuptimin e fjalëve dhe të frazeologjizmave që paraqiten në tekstet letrare dhe mediatike, dallojnë llojet e leksemave në aspektin e prejardhjes dhe sferën e përdorimit, i kuptojnë marrëdhëniet kuptimore midis tyre. – SHQI.AM.M.1.10. Analizojnë veçoritë e stileve funksionale dhe e kuptojnë rëndësinë e përdorimit të tyre. – SHQI.AM.M.1.11. Lidhin veprat letrare me kontekstin historiko-shoqëror; i njohin karaktersitikat kryesore të periudhave letrare dhe i lidhin ato me veprat letrare dhe autorët. – SHQI.AM.M.1.12. Dallojnë veçoritë e llojeve letraro-shkencore si dhe karakteristikat e llojeve të ndryshme të të shprehurit mediatik. – SHQI.AM.M.1.13. Dallojnë autorin e veprës letrare nga narratori, personazhi dramatik apo subjekti lirik gjatë analizës	teksti. – SHQI.AM.M.2.6. Analizojnë problemin e ndarë; kuptojnë dhe i interpretojnë tekstet, idetë poetike, stilet gjuhësore, karakteristikat përbërëse të tekstit. – SHQI.AM.M.2.7. Vlerësojnë rolin që ka forma, stili dhe lloji i tregimit në formimin e kuptimit të veprës letrare. – SHQI.AM.M.2.8. Vlerësojnë veprimet dhe karakteristikat e personazheve duke formuar qëndrime morale nga këndvështrimi i barazisë së njerëzve. – SHQI.AM.M.2.9. Përcaktojnë këndvështrimet dhe qëndrimin e autorit, dallojnë të shprehurit subjektiv nga ai objektiv, dallojnë figurat stilistike, humorin, ironinë dhe satirën. – SHQI.AM.M.2.10. Formojnë tekst në të shkruar ose gojor (duke riorganizuar përmbajtjen, duke i lidhur pjesët dhe duke e strukturuar përmbajtjen në tërësi). – SHQI.AM.M.2.11. Në mënyrë të pavarur i gjejnë dhe i lidhin informacionet nga tekstet nga fusha të ndryshme dhe i përdorin ato për të mësuar si dhe në situata të caktuara	strategjitë e të lexurit dhe të mësuarit në mënyrë individuale ndaj qëllimit; janë të aftë që ta korrigjojnë qasjen e tyre. – SHQI.AM.M.3.7. Zgjerojnë interesimin e tyre për të lexuar nga tekste të ndryshme jolettrare në ato kombëtare dhe botërore. – SHQI.AM.M.3.8. Kuptojnë lidhjen ndërmjet letërsisë dhe kulturës; duke lexuar formojnë qëndrimet e tyre estetike dhe etike dhe i arsyetojnë ato me argumente. – SHQI.AM.M.3.9. Përdorin njohuritë nga gjuha dhe letërsia për të krijuar dhe për të bërë vlerësim kritik për përmbajtjet e ndryshme kulturore. – SHQI.AM.M.3.10. Hartojnë tekste të ndërlikuara me shkrim dhe me gojë duke u bazuar në përvoja personale, shfrytëzojnë literaturë themelore dhe sekondare. – SHQI.AM.M.3.11. Respektojnë ndryshimet kulturore në vend, vlerësojnë trashëgiminë kulturore, kanë nevoja kulturore dhe dinë se si t'i realizojnë. – SHQI.AM.M.3.12. Shpjegojnë
--	---	--

së veprës letrare. – SHQI.AM.M.1.14. Përcaktojnë elementet letrare të strukturës në aspektin retrospektiv e kronologjik të tregimit, fabulën dhe syzheun; karakterizojnë llojet e karaktereve kryesore sipas cilësive (fizike, psikologjike, gjuhësore, shoqërore dhe etike). - SHQI.AM.M.1.15. Emërtojnë mjetet gjuhësore dhe stilistike dhe kuptojnë funksionin e tyre në tekst.	në jetën e përditshme. – SHQI.AM.M.2.12. Marrin pjesë në diskutime publike; debatojnë me argumente dhe kundërgjendje, të dëgjuarit aktiv dhe duke respektuar pozicionin e tjetrit, gjendjen emocionale dhe njohjen e argumenteve bazuar në emocione.	ndikimin e dëmshëm të paragjykitimeve dhe stereotipeve në arsim, në kontekstin privat e shoqëror; promovojnë kulturën e paqes dhe jo dhunës si dhe tolerancën. – SHQI.AM.M.3.13. Përdorin strategji të menduarit kritik për të verifikuar informacionet në tekste të ndryshme. – SHQI.AM.M.3.14. Krahason mjetet shprehëse letrare, teatrore dhe kinematografike gjatë interpretimit të motiveve me tema të ngjajshme.
---	--	---

Niveli i përparuar

Kompetenca specifike lëndore 1 (KSL1) Nxënësit kuptojnë funksionin e gjuhës dhe të letërsisë. Kanë njohuri të detajuara për gramatikën e gjuhës shqipe (theksin, përbërjen e fjalës, kuptimin e rasave dhe format foljore, strukturën e fjalorit). Përvetësojnë mënyrat me shkrim dhe me gojë gjatë shkollimit, pjesëmarrje qytetare dhe shoqërore. Vlerësojnë veprimet dhe stilet në tekstet joartistike dhe letrare dhe e interpretojnë rolin e tyre në lloje të ndryshme të teksteve. Kuptojnë dhe vendosin lidhjen midis letërsisë dhe arteve të tjera, shkencës dhe teknologjisë. Zhvillojnë aftësitë personale, kombëtare dhe identitetin kulturor, ndërgjegjësim për përkrahësin në trashëgiminë kulturore europiane e botërore në bazë të veprave vendore dhe atyre botërore, artit teatral dhe kinematografik, trashëgimisë kulturore e shkencore dhe formave të ndryshme kulturo-meditike.
Kompetenca specifike lëndore 2 (KSL 2) Nxënësit flasin hapur dhe lirshëm madje edhe para një auditoriumi më të madh për temat që kanë të bëjnë me gjuhën, letërsinë dhe kulturën. Dallojnë mundësitë kërkimore dhe të duhura gjatë procesit të mësimin të gjuhës dhe letërsisë si dhe i zbatojnë njohuritë e fituara si shkathtësi në jetën e përditshme. Hulumtojnë karakteristikat e

regjistrin dhe stilet që lidhen me fjalorët dhe përzgjedhjen e shprehjeve të duhura gjuhësore. Krahason informacionet nga disiplina të ndryshme dhe burime mediatike dhe kanë qasje kritike.

Kompetenca specifike lëndore 3 (KSL 3)

Nxënësit kanë shprehuri dhe nevojë që ta zhvillojnë kulturën e folurit dhe të shprehurit, ashtu si për përsosje personale ashtu edhe për pjesëmarrje në jetën qytetare dhe shoqërore. Përcjellin ndikimin socioekonomik të ecurisë së gjuhës, letërsisë, kulturës dhe shkencës; kujdesen edhe për mënyrën e jetesës në bashkësi. Kultivojnë qasje humane dhe kritike në dialogjet ndërkulturore. Janë të gatshëm të ndërmarrin përgjegjësi për zgjedhjet dhe vendimet të cilat ndikojnë në jetën e tyre si dhe jetën e komunitetit.

Rezultatet e ciklit arsimor (RCA) për përfundimin e arsimit të mesëm:

Niveli i përparuar

KSL 1	KSL 2	KSL 3
<i>Nxënësit:</i>	<i>Nxënësit:</i>	<i>Nxënësit:</i>
– SHQI.AM.P.1.1. Kuptojnë njësitet dhe funksionet themelore të gjuhës. – SHQI.AM.P.1.2. Njohin koceptet e gjuhësisë (parimin fonetik, morfologjik dhe etimologjik) si dhe njohuritë përkatëse të gjuhës. – SHQI.AM.P.1.3. Përcaktojnë vendin e theksit në fjalën e dhënë. – SHQI.AM.P.1.4. Njohin termin fonemë; përcaktojnë të gjitha alternimet fonetike.	– SHQI.AM.P.2.1. Krahason veçoritë gjuhësore në gjuhën e tyre dhe në gjuhët tjera, analizojnë dhe nxjerrin konkluzione. – SHQI.AM.P.2.2. Interpretojnë veprën letrare duke kuptuar karakteristikat e tyre në kontekstin historiko-letrar, duke u bazuar në analizë strukturore dhe elementet stilistike të veprës duke përdorur terminologjinë historiko -letrare dhe burimet dytësore. – SHQI.AM.P.2.3. Vlerësojnë funksionin e mjeteve stilistike në tekst.	– SHQI.AM.P.3.1. Kuptojnë fuqinë e gjuhës si mjet shprehës në dimensione të ndryshme të përvojës njerëzore (shoqërore, kulturore, morale, shpirtërore dhe estetike). – SHQI.AM.P.3.2. Në mënyrë kritike hulumtojnë dhe vlerësojnë informacionet nga mediet e ndryshme; janë në gjendje të dallojnë llojet e ndryshme të manipulimeve mediatike dhe ndikimin e tyre në formimin e realitetit. – SHQI.AM.P.3.3. Zhvillojnë stilin e tyre personal për të shprehurit verbal

– SHQI.AM.P.1.5. Njohin dhe kuptojnë termin morfemë. – SHQI.AM.P.1.6. Përcaktojnë format me parashtesa, prapashtesa, të përbëra me kompozim, përngjitje. – SHQI.AM.P.1.7. Njohin kuptimet e rasave si dhe trajtat e foljeve. – SHQI.AM.P.1.8. Analizojnë tekstin duke dalluar diatezën veprorë dhe joveprorë, marrëdhëniet bashkërenditëse dhe nënrenditëse të fjalive. – SHQI.AM.P.1.9. Zbatojnë rregullat kryesore të lakimit. – SHQI.AM.P.1.10. Dallojnë në tekst figurat stilistike, dallojnë shtresat leksikore, njohin metaforën, metoniminë, sinegdotën ..., si figura leksikore. – SHQI.AM.P.1.11. Shpjegojnë karakteristikat gjuhësore, stilistike, estetike dhe strukturore të veprave letraro-artistike dhe teksteve letraro-artistike duke përdorur terminologjinë teoriko-letrare. – SHQI.AM.P.1.12. Vlerësojnë aspektet stilistike në tekstet letrare dhe ato joletrare si dhe	– SHQI.AM.P.2.4. Analizojnë problemin, idenë dhe mesazhin në tekstin letrar dhe joletrar duke i shikuar nga perspektiva të ndryshme; gjejnë dhe vlerësojnë argumentet, i radhisin i rishikojnë dhe eventualisht i korrigjojnë qëndrimet e tyre. – SHQI.AM.P.2.5. Lidhin temat historike, fetare, politike në pjesët dhe në këtë mënyrë formojnë identitetin e tyre; shpjegojnë dhe krahasojnë mënyrat kreative gjatë paraqitjes së ideve në kultura të ndryshme. – SHQI.AM.P.2.6. Përshtatin qëllimin e përmbajtjes dhe mënyrën e të shprehurit me situatën përkatëse. – SHQI.AM.P.2.7. Hulumtojnë marrëdhëniet midis teorive të caktuara (ekzistencializmi, teoria e recepcionit/pjesa e hapur) dhe tekstit letrar-artistik dhe raportet mes vet teksteve letrare-artistike (intertekstualiteti); transmetojnë njohuri teorike në kontekst të ri. – SHQI.AM.P.2.8. Përpilojnë lloje të ndryshme të teksteve duke përdorë stile të duhura funksionale dhe format e të shprehurit. – SHQI.AM.P.2.9. Hulumtojnë dhe krahasojnë informacione nga disiplina të ndryshme dhe burime mediatike, duke	dhe joverbal duke inkurajuar ndërveprim pozitiv dhe bashkëpunim me të tjerët. Vlerësojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre komunikative me një qëndim për arritjen e qëllimeve. – SHQI.AM.P.3.4. Kanë marrëdhënie interaktive me mediet me gatishmërinë që të marrin pjesë në aktivitetet e bashkësisë dhe komunitetit. – SHQI.AM.P.3.5. Vërejnë dhe e përcjellin zhvillimin dhe ndikimin e artit, shkencës dhe teknologjisë në gjuhë; kujdesen për ruajtjen e monumenteve kulturorohistorike, për sigurinë dhe mirëmbajtjen e mjedisit jetësor. – SHQI.AM.P.3.6. Thellojnë kuptimin dhe përvetësimin e strategjive të ndryshme dhe teknikave të të lexuarit dhe të të mësuarit me vetëdije për forcat dhe mangësitë e tij. – SHQI.AM.P.3.7. Duke lexuar zgjerojnë horizontet e tyre dhe zhvillojnë botën e tyre meditative dhe emocionale, të gatshëm për përgjegjësi për zgjedhje e vendime të cilat ndikojnë në jetën e tyre dhe të shoqërisë. – SHQI.AM.P.3.8. Njohin kultura të ndryshme përmes letërsisë së rajonit, Europës dhe botës dhe kultivojnë
--	--	--

bëjnë krahasime me dy tekste ose më shumë; shpjegojnë rolin e tyre në realizimin dhe rëndësinë e këtyre teksteve.	krijuar qasje kritike ndaj tyre. – SHQI.AM.P.2.10. Flasin hapur para një auditoriumi të madh për tema nga gjuha, letërsia dhe kultura. – SHQI.AM.P.2.11. Në mënyrë aktive marrin pjesë në debate (parapërgatiten për të, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me grupin, me argumente shfaqin qëndrimin e tyre, paraqesin përfundime dhe krijojnë strategji).	lidhje humane e kritike midis kulturave. – SHQI.AM.P.3.9. Vlerësojnë përmbajtje të ndryshme kulturore duke njohur dhe realizuar vlerën perosnale, shoqërore dhe komerciale. – SHQI.AM.P.3.10. Vlerësojnë gjuhën si kulturë kombëtare, trashëgimi kombëtare si dhe llojllojshmërinë kulturore të vendit të tyre, rajonit, Europës dhe botës. – SHQI.AM.P.3.11. Hulumtojnë ndikimin e stereotipeve dhe paragjytimeve ndaj individit apo shoqërisë duke u angazhuar për të drejtat e njeriut dhe zgjidhjen e konfliktit në mënyrë paqësore. – SHQI.AM.P.3.12. Vlerësojnë në mënyrë kritike veprat letrare, teatrore dhe filmike.
--	--	---